

VENDIM
Nr. 186, datë 9.3.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PIKË
PANORAMIKE DHE SPORTIVE, LLOGORA, HIMARË”.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Pikë panoramike dhe sportive, Llogora, Himarë”.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë kullotë”, me vlerë të përgjithshme prej 2 515 332.90 (dy milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë nëntëdhjetë) lekësh.
4. Vlera totale e shpronësimit, prej 2 515 332.90 (dy milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë nëntëdhjetë) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Himarë.
8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transak-sionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, gjithashtu, kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR PROJEKTIN
“PIKË PANORAMIKE DHE SPORTIVE, LLOGORA, HIMARË”

Nr .	Nr. pasurie	Z. kadastrale	Pronari / emër e mbiemër	Sip. tokë kullotë m ²	Çmimi tokë kullotë lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime
1	376	2863	Bashkëpronarë: Paskal Babe, Ilia Babe, Foto Babe, Areti Gjini, Lluka Babe, Sotiraq Kokuri, Foto Kokuri, Petro Kokuri, Kalipso Kokuri, Argjiro Kokuri, Antoneta Toska, Xhuljeta Haxhisi, Poliksen Sulaj, Pandeli Pano, Niko Pano, Sofie Furxhi, Marie Thodhoriani, Thoma Mehilli, Kasiani Mehilli, Frosina Boci, Margarita Mehilli, Vasil Nesturi, Andon Nesturi, Kozman Nesturi, Paskal Nesturi, Roland Nesturi, Angjeliqi Margariti	10.936,23	230	2.515.332,90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
			TOTALI I SHPRONËSIMIT			2.515.332,90	